



## Oda e Stomatologëve të Kosovës

Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosovo

Prishtinë

Datë: 10.06.2026

### Drejtuar:

KUVENDIT TË KRYEQYTETIT PRISHTINË  
DREJTORISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE INOVACIONIT  
ANËTARËVE TË GRUPIT PUNUES

**Lënda:** Reagim dhe kërkesë për rishqyrtim të Draftit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01.nr.110-2782, datë 02.12.2011, për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale

I nderuar z. Fehmi Kupina, Kryetar i Kuvendit të Kryeqytetit,

Të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal,

I nderuar z. Luftar Braha, Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimi Ekonomik dhe Inovacionit,

Të nderuar anëtarë të Grupit Punues për hartimin e Draftit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01.nr.110-2782, datë 02.12.2011, për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale.

Oda e Stomatologëve të Kosovës (OSK), si organizatë profesionale dhe rregullatore e licencuar me ligj për përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave profesionale të doktorëve të stomatologjisë në Republikën e Kosovës, ka shqyrtuar Draftin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01.nr.110-2782, datë 02.12.2011, për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale, në veçanti dispozitën që parasheh pagesën vjetore prej 2,000.00 euro për aktivitetin 8623 – Aktivitetet e dentistëve.

Pas analizimit të draftit, Oda e Stomatologëve të Kosovës shpreh shqetësimin e saj të thellë lidhur me nivelin e ngarkesës financiare të propozuar dhe kërkon rishqyrtimin e kësaj dispozite për arsyet në vijim:

Pas analizimit të draftit, Oda e Stomatologëve të Kosovës shpreh shqetësimin e saj të thellë lidhur me nivelin e ngarkesës financiare të propozuar dhe kërkon rishqyrtimin e kësaj dispozite për arsyet në vijim:

### **1. Veprimtaria stomatologjike tashmë i nënshtrohet detyrimeve të veçanta financiare dhe administrative**

Ordinancat stomatologjike nuk janë subjekte afariste të zakonshme, por institucione shëndetësore private të cilat regjistrohen, licencohen dhe mbikëqyren nga Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës. Për ushtrimin e veprimtarisë së tyre ato paguajnë taksa dhe tarifa të rregullta administrative, për licencimin dhe funksionimin e institucionit shëndetësor. Vendosja e një ngarkese shtesë komunale prej 2,000 euro në vit do të krijonte një barrë disproporcionale financiare ndaj ofruesve të shërbimeve stomatologjike.

### **2. Kryeqyteti nuk ka kompetencë në licencimin dhe legjitimimin e veprimtarisë stomatologjike**

Licencimi, autorizimi, inspektimi profesional dhe përcaktimi i kushteve për ushtrimin e veprimtarisë stomatologjike janë kompetenca të institucioneve qendrore dhe organeve profesionale të autorizuar me ligj. Përderisa Kryeqyteti nuk ushtron kompetenca në regjistrimin, licencimin apo përcaktimin e standardeve profesionale për ordinancat stomatologjike, vendosja e një tarife të lartë fikse nuk reflekton ndonjë shërbim administrativ apo kompetencë të drejtpërdrejtë që ofrohet ndaj këtyre institucioneve.

### **3. Ordinancat stomatologjike nuk kanë qenë subjekt i taksave të tilla komunale deri më tani**

Historikisht, institucionet stomatologjike private në Kryeqytet nuk janë ngarkuar me tarifa të tilla administrative komunale. Për këtë arsye, vendosja e menjëhershme e një tarife prej 2,000 euro paraqet një ndryshim të konsiderueshëm financiar, pa një analizë të qartë të ndikimit ekonomik dhe social mbi sektorin e stomatologjisë.

### **4. Veprimtaria stomatologjike nuk gjeneron të ardhura të njëjta për të gjitha ordinancat**

Shërbimet stomatologjike nuk janë uniforme dhe dallojnë dukshëm nga një ordinancë në tjetrën. Jo të gjitha ordinancat ofrojnë të njëjtat lloje shërbimesh, nuk kanë të njëjtin numër pacientësh dhe as të njëjtin kapacitet ekonomik. Vendosja e një tarife fikse për të gjitha ordinancat, pa marrë parasysh madhësinë, qarkullimin, numrin e të punësuarve apo llojin e shërbimeve të ofruara, bie ndesh me parimin e proporcionalitetit dhe trajtimit të drejtë fiskal.

## **5. Rreziku i mbylljes së ordinancave dhe reduktimit të vendeve të punës**

Një numër i konsiderueshëm i ordinancave stomatologjike në Kryeqytet operojnë me kapacitete minimale, me vetëm një njësi pune dhe shpesh me orar të kufizuar pune, kryesisht në orët e pasdites. Për këto ordianca, një ngarkesë vjetore prej 2,000 euro do të përbënte barrë të rëndë financiare, e cila mund të ndikojë drejtpërdrejt në qëndrueshmërinë e veprimtarisë së tyre, reduktimin e vendeve të punës apo edhe mbylljen e tyre.

## **6. Ndikimi në qasjen e qytetarëve në shërbime stomatologjike**

Rritja e kostove operative të ordinancave stomatologjike në mënyrë të pashmangshme reflektohet në rritjen e kostos së shërbimeve për qytetarët. Kjo bie ndesh me interesin publik për qasje më të lehtë dhe më të përballueshme në shërbimet shëndetësore orale.

## **7. Respektimi i parimit të proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë fiskal**

Sipas parimeve themelore të administratës publike dhe të së drejtës fiskale, çdo ngarkesë financiare e vendosur ndaj subjekteve ekonomike duhet të jetë proporcionale me qëllimin që synon të arrijë dhe me kapacitetin ekonomik të subjekteve që ngarkohen me të. Tarifa e propozuar prej 2,000 eurosh në vit për ordinancat stomatologjike paraqet një ngarkesë të njëjtë për të gjitha institucionet stomatologjike, pavarësisht madhësisë së tyre, numrit të të punësuarve, qarkullimit vjetor apo gamës së shërbimeve që ofrojnë. Një qasje e tillë nuk reflekton gjendjen reale ekonomike të sektorit dhe mund të prodhojë efekte diskriminuese ndaj ordinancave të vogla dhe atyre me kapacitete të kufizuara financiare.

## **8. Mungesa e një analize të ndikimit ekonomik**

Nga dokumentacioni i publikuar nuk rezulton të jetë paraqitur një analizë e detajuar e ndikimit ekonomik që kjo tarifë do të ketë ndaj institucioneve shëndetësore private, veçanërisht ndaj ordinancave stomatologjike. Vendosja e një ngarkese të tillë financiare pa një vlerësim paraprak të ndikimit në funksionimin e ordinancave, në punësim dhe në koston e shërbimeve për qytetarët, rrezikon të prodhojë pasoja negative si për profesionistët e stomatologjisë ashtu edhe për qytetarët e Kryeqytetit.

## **9. Kontributi i ordinancave stomatologjike në shëndetin publik**

Ordinancat stomatologjike private përbëjnë pjesë të rëndësishme të sistemit shëndetësor në Republikën e Kosovës dhe bartin një pjesë të konsiderueshme të barrës së ofrimit të shërbimeve të shëndetit oral për qytetarët. Përmes investimeve të vazhdueshme në pajisje, materiale, teknologji

moderne dhe edukim profesional të stafit, këto institucione kontribuojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e shëndetit publik dhe në uljen e ngarkesës së institucioneve publike shëndetësore. Për rrjedhojë, politikat fiskale ndaj këtij sektori duhet të jenë mbështetëse dhe jo dekurajuese.

Duke marrë parasysh sa më sipër, Oda e Stomatologëve të Kosovës kërkon që dispozita e propozuar për aktivitetin 8623 – Aktivitetet e dentistëve të rishqyrtohet dhe të hiqet nga drafti, respektivisht të reduktohet në një nivel simbolik dhe proporcional me natyrën e veprimtarisë stomatologjike dhe kapacitetet reale ekonomike të ordinancave stomatologjike.

Njëkohësisht, Oda e Stomatologëve të Kosovës shpreh gatishmërinë e saj për të marrë pjesë në çdo diskutim publik apo grup punues që do të trajtojë këtë çështje, me qëllim të gjetjes së një zgjidhjeje të drejtë, të arsyeshme dhe në interes të qytetarëve dhe profesionistëve të stomatologjisë.

Me respekt,

Kryetari i Odës së Stomatologëve të Kosovës

Prof. Dr. Blerim Kamberi

